

## Regullorja e konkursit online - Kompletu sondazhet online dhe grumbullo pikë -

### **Organizatori:**

- Konkursi që organizohet është i konceptuar dhe administrohet nga **iSense Solutions International Research SRL**, e cila përfaqësohet ligjërisht nga administratorit, dhe i cili do të quhet në vazhdimësi **organizatori**.
- Konkursi do të zhvillohet në bazë të Rregullores së mëposhtme, dispozitat e së cilës janë të detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit e panelit.

### **Përkufizime:**

Termat e mëposhtëm, ashtu siç janë përdorur në rreshtat në vazhdim, kanë kuptimet si më poshtë:

- "Fituesi" është pjesëmarrësi i panelit, i cili ka mbledhur, mbas kompletimit të sondazheve, një numër prej 3000 pikësh dhe klikoni në butonin "Tërhiqni shpërblimin" nga llogaria i cili do të marrë si çmim një shpërblim prej 30 euro.
- "Paneli" është platforma në të cilën mund të regjistrohet vullnetarisht çdo person që përdor internetin dhe i cili ka qenë dakort për të marrë pjesë në mënyrë të rregullt në sondazhe.
- "Panelisti" është personi i cili është regjistruar në panel dhe i cili kompletion pyetësorët online.
- "Sondazhi" ose "pyetësori" i referohet instrumentit online nëpërmjet të cilit një pjesëtar i panelit shpreh mendimin e tij për produktet dhe shërbimet që janë subjekti i pyetësorit.

### **Kohëzgjatja dhe zona a zhvillimit të konkursit:**

- Konkursi zhvillohet në territorin e më shumë vendeve (Bullgaria, Kroacia, Serbia, Sllovenia, Shqipëria, SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania).

- Konkursi zhvillohet për një periudhë prej 12 muajsh, duke qenë e mundur që të zgjatet automatikisht me periudhat pasuese prej 30 ditësh, deri në vendimin e organizatorit të ndërprerjes.

### **Pjesëmarrësit**

- Regjistrohen në këtë konkurs të gjithë personat që kanë një kont në Sense Panels.
- Mund të marrë pjesë në konkurs çdo person fizik, duke filluar nga mosha 16 vjeç, i cili ka një kont/llogari dhe një adresë e-mail-i të vlefshme në panelet online Sense Panels dhe që ka statusin "Aktiv" në panel (që u përgjigjet shpesh pyetësorëve, nuk ka adresë e-mail të gabuar, që nuk e ka ç'aktivizuar kontin/llogarinë e vet, që nuk është deklaruar jo aktiv dhe që ka dhënë dakortësinë për të marrë pjesë në studime nëpërmjet pjesëmarrjes në panel).
- Në qoftë se një anëtar i Sense Panels nuk i përgjigjet një sondazhi për një periudhë 12 mujore, në kushtet kur ai e ka marrë ftesën për studimin, iSense Solutions International Research SRL (Sh.P.K.) ka të drejtën ta deklarojë këtë person jo aktiv. Organizatori ka të drejtë t'i fshijë të gjithë anëtarët e panelit që nuk kanë qenë aktivë përgjatë një viti të tërë.
- Çdo anëtar i Sense Panels është i lirë të shprehë në çdo moment dëshirën për të dalë nga paneli. Në momentin kur një person vendos të fshijë kontin/llogarinë e vet, të dhënat e këtij personi do të jenë të fshira nga baza e të dhënave dhe këtë person nuk do të jetë e mundur më për ta kontaktuar. Në rastin se ky person dëshëron të futet përsëri në panel, ai mund të regjistrohet përsëri, por do të humbasë pikët që ka mbledhur më përpara.

### **Mekanizmi i konkursit**

- Personat që dëshërojnë të marrin pjesë në konkurs duhet të regjistrohen në Sense Panels, duke aksesuar formularin e regjistrimit.
- Personat e regjistruar në Sense Panels marrin ftesa për të kompletuar sondazhet online në adresën e e-mail-it me të cilin janë regjistruar në panel.
- Për çdo sondazh pjesëmarrësit marrin pikë. Numri i pikëve të marra ndryshon në funksion të kohëzgjatjes së sondazhit.

- Në ftesat që pjesëmarrësit e panelit marrin janë të përcaktuara edhe kohëzgjatja e pyetësorit si dhe pikët që i përkasin këtij pyetësori.
- Përfitojnë pikët vetëm personat që kanë statusin “komplet” për atë sondazh (që kualifikohen për studimin, që plotësojnë pyetësorin dhe që e çojnë pyetësorin deri në fund).
- Numri i pikëve të marra ndryshon në funksion të kohëzgjatjes së pyetësorit.
- Gjithashtu, pjesëmarrësit mund të shikojnë pikët e grumbulluara mbas çdo sondazhi në kontin e panelit.

### **Çmimet që akordohen**

- Akordohen një numër i kufizuar çmimesh që kanë vlerën 30 euro.
- Personat e regjistruar në panel do të marrin 30 de euro pasi të kenë grumbulluar 3000 pikë nga kompletimi i pyetësorëve online dhe klikoni në butonin "Tërhiqni shpërblimin" nga llogaria. 100 pikë ekuivalohet me 1 EURO.

### **Procedura e dhënies së shpërblimit**

- Organizatori merr një njoftim nga platforma e konkursit në rastin kur një pjesëmarrës në panel është i inkuadruar si fitues dhe kërkon shpengimin e çmimit, dhe do t'i kërkojë këtij të fundit, nëpërmjet e-mail-it, informacionet e duhura për marrjen e çmimit (Mbiemri, Emri, Llogari bankare).
- Çmimet do të jepen një herë në muaj, në datën 18 të çdo muaji. Nëse një pjesëmarrës grumbullon 3000 pikë mbas datës 18 të muajit në vazhdim, ai do t'i marrë lekët e shpërblimit në datën 18 të muajit që vjen.
- Në qoftë se data 18 e muajit koinçidon me ditën e shtunë ose të djelë, shpërblimi do të transferohet në ditën e parë të punës mbas datës 18 të muajit. Mund të shfaqen edhe vonesa eventuale për pagesën deri në 10 ditë pune.
- Në qoftë se një person nuk ka dërguar informacionet e nevojshme për marrjen e pagesës/shpërblimit deri në datën 17 të muajit në vazhdim, do ta marrë shpërblimin në datën 18 të muajit që vjen.

min muajin që vjen, me vërejtjen se duhet që ai të plotësojë të gjitha kushtet dhe procedurën e përcaktuar.

- Informacionet mbi identitetin tuaj janë të nevojshme për të vlerësuar faktin që çmimin e fiton personi që është emëruar si fitues. Këto informacione duhen edhe për deklarimin e çmimeve nga organizmat publike kompetente. Dokumentet ruhen në zyrën e kontabilitetit, në përputhje me ligjin.
- Mbas tërheqjes së shpërblimit, pikët e panelistit do të llogariten duke filluar nga 0, dhe kur ky do të grumbullojë 3000 pikët e tjera, ky do të shpallet përsëri fitues.

### **Mosmarrëveshjet:**

Kjo Rregullore është e aplikueshme për të gjithë pjesëmarrësit në Konkursin iSENSE SOLUTIONS INTERNATIONAL RESEARCH S.R.L (sh.p.k.), shoqëri tregtare e regjistruar në Rumani, me zyrë qendrore në Bukuresht, në adresën: IVY Office, Occidentului 3rd, 3rd floor | 010981, Bucharest, Romania, me Kod të Identifikimit Fiscal (NUIS) nr RO RO35015004 dhe e regjistruar në Regjistrin e Tregëtisë në Bukuresht me nr. J40/11410/17.09.2015, adresa e e-mail [support@sensepanels.com](mailto:support@sensepanels.com) personi i kontaktit.

Shoqëria iSense Solutions International Research është sponsorizuesi i konkursit.

Konkursi zhvillohet në përputhje me Rregulloren hartuar sipas legjislacionit kombëtar në fuqi të organizatorit, pikërisht, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në territorin e Rumanisë.

Në rastin e ndonjë mosmarrëveshjeje, palët do ta zgjidhin në rrugë mirëkuptimi. Në situatën e ndonjë konflikti të pazgjidhur, kjo mbetet në kompetencën e gjykatave në Rumani, sipas legjislacionit të aplikueshëm në territorin e Rumanisë.

### **Taksa dhe Tatime**

Organizatori ka detyrimin të paguajë tatimet e detyrueshme për fitimet që dalin nga çmimet e fituara nga fituesit, ashtu siç parashikohet në këtë rregullore, në përputhje me dispozitat e Kodit Fiskal, dhe çdo lloj detyrimi tjetër me karakter fiskal apo të një natyre tjetër në lidhje me këtë, mbetet në ngarkimin ekskluziv të fituesit.

### **Klauzola të tjera**

- Rregullorja mund të kërkohet falas nga pjesëmarrësit në konkurs nëpërmjet një kërkesë të dërguar në adresën e e-mail: [support@sensepanels.com](mailto:support@sensepanels.com)
- Rregullorja është publike dhe mund të aksesohet në faqen : <https://sensepanels.com>